



| | | | |
|---|--------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranimi / Dorezimi Priljezi/Priljezi Received/Delivered | 19.01.2023 | viti god Year | 3 |
| Organ / Institucija Org / Inst | Nr Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMSHICK | 578/2023 | | 112 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1130/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.1130/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesja Mimoza Neziri, me adresë banimi Rr. "Hysen Gjakolli", Fushë Kosovë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 19.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.1130/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesja Mimoza Neziri.

A r s y e t i m

Ankuesja Mimoza Neziri-Osmani, me datë 09.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 7825/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 7079 të datës 30.11.2022 të Komisionit për Ankesa të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pretendimet ankimore se konkursi i datës 04.08.2022 për pozitën "Zyrtar Administrativ" ka qenë i njëanshëm, jo objektiv dhe i pa bazuar në meritat e kandidatëve të përzgjedhur.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në nenin 79, 80 dhe 81 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, me datë 04.11.2022 ka shpallur Konkursin për nëpunës administrativ dhe mbështetës për pozitën "zyrtar administrativ", 50 pozita, me afat prej një viti.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht më nenin 2 është përcaktuar se; "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen

veprintari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprintari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se " Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës" rrjedhimisht po mbi këtë bazë ligjore është bërë edhe shpallja e Konkursit të kontestuar me ankesë.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, konstaton së nëpunësi administrativo-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Kosovës si dhe nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Kolegji konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës së nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, kështu që mbi këtë bazë, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses Mimoza Neziri Osmani.

Andaj, marr parasysh konstatimin si me lartë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1130/2022 të datës 09.12.2022, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit publik, e njëjta udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës, pasi që lënda nuk mund të bartet të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1130/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Ilire Mehmeti-Shaqiri
Procedsmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Mimoza Neziri;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

